

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrori: Mbrojtësi i specializuar i Nasim Haradinajt

Datë: 12 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime të Mbrojtjes për konferencën VI mbi ecurinë e çështjes

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit e Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Mbrojtësit e Hysni Gucatit

Xhonathan Elistan Riz QC

Hju Bouden

I. KLASIFIKIMI

1. Mbrojtja i qëndron mendimit se është e përshtatshme që këto parashtrime të klasifikohen si publike dhe rithekson edhe një herë parashtrimet e saj të mëparshme se i qëndron mendimit se të gjitha parashtrimet mund të konsiderohen rregullisht publike për hir të transparencës.

II. HYRJE

2. Më 23 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi kalendarin e mbetur me anë të një urdhri me shkrim,¹ që anuloi konferencën e gjashtë mbi ecurinë e çështjes, fillimisht e parashikuar për datën 25 qershor 2021, dhe e shtyu këtë konferencë për më datë 14 korrik 2021.
3. Vërejmë se në atë urdhër nuk kërkoheshin parashtrime me shkrim; megjithatë, Mbrojtja e z. Haradinaj e konsideron të përshtatshme dorëzimin e parashtrimeve me shkrim për ta informuar Gjykatën lidhur me qëndrimin, sa u takon pikave të ngritura në urdhrin e lartpërmendur.

III. PARASHTRIMET

¹ KSC-BC-2020-07/F00244

4. Parashtrimet ndjekin renditjen sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

Objekti i Paraburgimit

5. Mbrojtja u qëndron shqetësimeve të ngritura më parë, pra që masat tejet kufizuese të vendosura gjatë pandemisë së COVID-19 nuk i kanë dhënë mundësi mbrojtjes të bëjë përgatitjet e duhura në këtë çështje. Vërejmë se Zyra Administrative ka ndërmarrë hapa për ta përmirësuar situatën me vendosjen e ekraneve kompjuterike. E mirëpresim këtë masë, por nuk është aspak e mjaftueshme dhe sistemi përdor një audio të dobët dhe nuk mund të eliminojë kufizimet e krijuara nga paneli i qelqtë ndarës.
6. Vërejmë se do të bëhet një përmirësim i mëtejshëm që përfshin heqjen e panelit të qelqtë ndarës në mënyrë që avokatët dhe klienti të mund të takohen në të njëjtën dhomë. Kjo është një masë e rëndësishme, megjithëse, për fat të keq, vjen në një moment kur procedura paraprake po shkon drejt një përfundimi të shpejtë dhe çështja gjyqësore po përgatitet për t'iu kaluar trupit gjykues.

Përkthimet

7. Me respekt parashtrojmë se qëndrimi i ndjekur Gjykata dhe nga Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk njeh statusin e institucioneve të përbashkëta.

Siç është shprehur Mbrojtja në parashtrimet e veta gojarisht gjatë konferencës

së pestë mbi ecurinë e çështjes, qëndrimi se duhen përkthyer vetëm dokumentet bazë thelbësore në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të DHSK-së është i keqkuptuar në themel. Kjo qasje mbështetet në qëndrimin e gabuar të ndjekur nga vetë institucioni sikur ky është një tribunal ndërkombëtar apo hibrid. Për të qenë të qartë, nuk është as ndërkombëtar e as hibrid. Është një institucion i brendshëm i cili rregullohet nga kuadri ligjor, rregullator dhe kushtetues i Republikës së Kosovës. Të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që paraqiten para institucionit/institucioneve kanë të drejtë që të gjitha materialet e çështjes t'i kenë me një gjuhë të cilën e kuptojnë. Është thjesht e papranueshme të vijohet mbi bazën se vetëm materiali bazë duhet të jetë në shqipe dhe se gjyqi mund të zhvillohet në anglishte me përkthim me gojë gjatë gjyqimit.

8. Parashtrojmë se nuk kemi të bëjmë me një shtetas të huaj që paraqitet para një gjykate të huaj në të cilën gjuha që ai flet nuk është gjuha e gjykatës apo e sistemit gjyqësor të vendit ku ndodhet kjo gjykatë.
9. Dhomat e Specializuara, si institucion i brendshëm, u nënshtrohen disa detyrimeve. Së pari, i gjithë materiali nga i cili përbëhen provat kundër të pandehurit duhet t'i vihet në dispozicion në një gjuhë të cilën ai e kupton dhe në kohën e duhur, në mënyrë që t'i jepet mundësi t'u japë udhëzime avokatëve mbrojtës për t'u përgatitur në mënyrë adekuate për gjyqin. Së dyti,

procesi duhet të zhvillohet në një gjuhë të cilën ai e kupton ose atij t'i vihet në dispozicion pa pagesë përkthim me gojë në të gjitha procedurat gjyqësore.

10. Fakti se mund të ketë kufizime buxhetore nuk i cenon të drejtat e të pandehurit në këtë aspekt. Autoriteti emëruar i DHSK-së, Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian ("EEAS"), vendosi të krijonte një institucion gjyqësor brenda sistemit të Kosovës në kuadër të së drejtës së brendshme të Kosovës dhe të detyrimeve të traktateve ndërkombëtare që rrjedhin nga Kushtetuta, dhe vendosi që personeli i institucioneve të jetë tërësisht i përbërë nga jo-shtetas, çka solli për pasojë që të gjitha materialet e çështjeve të duhet të jenë në disa gjuhë. Pavarësisht nga kjo, DHSK-ja ka detyrimin për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat e të gjithë personave që sillen përpara saj në përputhje me detyrimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare.

11. Mbrojtja nuk ka asnjë ankesë lidhur me kërkesën e dytë, përkthimi me gojë në gjykatë ofrohet, por parashtron se Dhomat e Specializuara nuk përmbushin kërkesën e parë. Kjo gjë, që përbën njëfarë shqetësimi, do të cenojë në fund gjykimin dhe drejtësinë e procesit kundër të pandehurit.

Nxjerrja e materialeve

12. Mbrojtja u qëndron parashtrimeve të mëparshme dhe në veçanti vërejmë se ZPS-ja është ende duke bërë nxjerrje, pavarësisht nga fakti se rregullisht ka konfirmuar se e ka nxjerrë të gjithë dokumentacionin.

13. Ky qëndrim është pranuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në urdhrin e tij² për kërkesën e ZPS-së për të vënë në dispozicion një përmbledhje³ dhe jo vetë provat.

14. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren në paragrafin 6 të urdhrin në fjalë:

“Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton që në fillim se, në vijim të zotimit të ZPS-së, afati për ta përfunduar të gjithë nxjerrjen e parashikuar në rregullën 102(1)(b) dhe për të nxjerrë material të rregullës 103 që ka ZPS-ja u caktua data 9 prill 2021. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia rikujton ZPS-së detyrimet e saj për nxjerrje dhe tërheq vëmendjen se çdo nxjerrje e vonët nuk është ide e mirë”

15. Edhe një herë, pra, shohim një tjetër shembull të mosrespektimit nga ana e ZPS-së të urdhrave të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe të mosveprimit të saj në mospërputhje me zotimet e veta, duke pësuar pak ose aspak pasoja.

16. Pra, sa i takon Mbrojtjes, qëndrimi i saj është se është tërësisht e pamundur për Mbrojtjen dhe për Dhomën e Specializuar për t’u bindur se ZPS-ja i ka përmbushur detyrimet e veta për nxjerrjen dhe, më tej, nëse do të ketë

² KSC-BC-2020-07/F00257

³ KSC-BC-2020-07, F00252/RED, Prokurori i Specializuar, Version i redaktuar konfidencial i Njoftimit të Prokurorisë dhe kërkesës së saj për të vënë në dispozicion një përmbledhje (“Kërkesa”), 5 korrik 2021, konfidencial.

vështirësi në vijimësi në lidhje me pjesën e mbetur të procesit, thjesht duke qenë se nuk e dimë ende pozicionin e saktë.

17. ZPS-ja nuk ka asnjë bazë për mosnxjerrjen e informacionit në fjalë përpara datës 9 korrik 2021 në Nxjerrjen 39, dhe përsëri vëmë në dukje se ZPS-ja nuk ka konfirmuar se kur e ka marrë në dorë informacionin që përmban Nxjerrja 39.
18. Fjala “shpërfillëse” është përdorur edhe më parë për ta përshkruar qasjen e ndjekur nga ZPS-ja sa i takon nxjerrjes dhe e njëjta vlen edhe këtu. Që në fillim të procesit nuk është ndjekur një qëndrim serioz kundrejt të pandehurit dhe në çdo moment Mbrojtjes i është dashur të luftojë për nxjerrjen, një proces që duhej të kishte qenë i thjeshtë dhe i pandërlikuar.
19. Pra, duhet ndjekur qëndrimi se nuk duhet të ketë asnjë problem në të ardhmen me nxjerrjen; por, Mbrojtja nuk mund të jetë e sigurt që nuk do të ketë, duke qenë se zotimet e bëra siç duket janë të pakuptim.
20. Gjithashtu, do të nënvizonim përsëri se paneli i Gjykatës së Apelit është duke shqyrtuar një vendim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe në varësi të vendimit të Dhomës, mund të urdhërohen nxjerrje të mëtejshme.
21. Pra, përsëri, pozicioni në këtë fazë mbetet i paqartë.
22. Ka mundësi të ketë edhe dy çështje të tjera për të cilat do të bëhen parashtrime në konferencën mbi ecurinë e çështjes; por, në pritje të qëndrimit të ZPS-së

dhe të temave që do të diskutohen, e informojmë Gjykatësin e Procedurës Paraprake se është pothuaj e sigurt se do të jetë nevoja për një periudhë të zhvilluar në “seancë të mbyllur”.

Aktakuza e korrigjuar

23. Mbrojta ka marrë tashmë aktakuzën e korrigjuar por vëren se nuk ka dalë një urdhër i mëtëjshëm nëse është në përputhje me urdhrin e panelit të Gjykatës së Apelit apo me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

Hetimet e mbrojtjes

24. Hetimet e Mbrojtjes janë ende në zhvillim dhe do të vijojnë gjatë periudhës së verës.

Kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues dhe gatishmëria për gjykim

25. Vërejmë se kërkohen parashtrime mbi këtë pikë, por duket se vendimi lidhur me të tashmë është marrë , po të kemi parasysh se paragrafi 22(e) i urdhrin i Gjykatësit të Procedurës Paraprake “cakton datën për kalimin e dosjes gjyqësore sipas rregullës 98(1) të Rregullores për të premtën, më 16 korrik 2021” .
26. Mbrojtja do të kërkonte, rrjedhimisht, sqarim nëse kjo është vendosur që përpara se të dëgjohen parashtrimet mbi këtë pikë.
27. Gjithashtu, çështja nuk është ende gati për gjykim dhe as nuk është gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues, për arsyet e mëposhtme:

- a. Nuk ka dalë një urdhër lidhur me Aktakuzën e korrigjuar;
 - b. Aktualisht paneli i Gjykatës së Apelit është duke shqyrtuar një çështje lidhur me nxjerrjen, për të cilën nuk ka gjasa të dalë vendim përpara datës 16 korrik 2021;
 - c. Ky vendim mbi apelin mund të kërkojë që ZPS-ja të bëjë nxjerrje të mëtejshme të konsiderueshme, çka ndikon në çdo afat të propozuar sa i takon vetë gjykimin dhe çdo kërkesë të mëtejshme me shkrim të Mbrojtjes;
 - d. Është bërë një kërkesë e mëtejshme për nxjerrje në lidhje me materiale të caktuara, për të cilën nuk është marrë ende vendim. Në varësi të rezultatit të kësaj kërkesë, mund të duhet të bëhen nxjerrje të tjera dhe/ose kërkesa të tjera drejtuar panelit të Gjykatës së Apelit; dhe
 - e. Ka një shkallë skepticizmi nëse procesi i nxjerrjes ka përfunduar, për arsyet e lartpërmendura.
28. Deri sa të zgjidhen këto probleme, Mbrojtja nuk është në gjendje të informojë se kur pret të jetë gati për të paraqitur provat e Mbrojtjes.

IV. VËREJTJE PËRMBYLLËSE

29. Mbrojtja vëren se nuk janë kërkuar parashtrime me shkrim, por duke pasur parasysh problemet e lindura, konsiderohet i domosdoshëm evidentimi me shkrim i disa çështjeve të caktuara përpara konferencës mbi ecurinë e çështjes.
30. Gjithashtu, duke pasur parasysh mundësinë që pjesërisht konferenca të bëhet në seancë të mbyllur, konsiderohet e përshtatshme që të vihet në dijeni për këtë fakt Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1690

/nënshkrimi/

Tobi Kadman

Mbrojtës i specializuar

/nënshkrimi/

Karl Bakli

Bashkëmbrojtës i specializuar